

mire nola pap
mang



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



PËR

PËR

UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI"

SHOQËRINË "TECHNOPLASTIC"

VLORË

VLORË

Nr. 245 Prot

Nr. 25 Prot

Vlorë më 17.01.2025

Vlorë më 17.01.2025

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

UNIVËRSITËTIT "ISMAIL QEMALI" VLORË
përfaqësuar nga Rektore e Universitetit Prof. Dr. Aurela SALIAJ

DHE

SHOQËRISË "TECHNOPLASTIC" Vlorë
përfaqësuar nga Administratori z. Altin DEMAJ

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë dhe Shoqërisë "Techno Plastic" Vlorë më poshtë të quajtura "palë".

Marrëveshja lidhet në mbështetje të Ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

Nisur nga interesi i përbashkët, palët bien dakort të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi (si më poshtë):

Neni 1 Baza Ligjore

Kjo Marrëveshje bazohet në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3, pika 4, gërma c).

Neni 2 Qëllimi dhe mënyra e bashkëpunimit

Marrëveshja ka për qëllim bashkëpunimin e ndërsjellë ndërmjet Universitetit të Vlorës "Ismail Qemali" Vlorë dhe shoqërisë TechnoPlastic Vlorë, duke përfshirë:

- Bashkëpunimin e pedagogëve të Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare, Stafit të shoqërisë "TechnoPlastic" Vlorë, si dhe studentëve për realizimin e detyrave të kursit, projekteve dhe kërkimit shkencor në fushat e Inxhinierive mekanike, Navale dhe Elektrike.
- Organizimin e aktiviteteve të përbashkëta për Edukimin në Vazhdimësi (konferenca, simpoziume, trajnime, workshop-e).
- Zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve pranë shoqëria "Techno Plastic" Vlorë, ku numri i studentëve që mund të qëndrojnë njëkohësisht do të dakortësohet me marrëveshje midis palëve përpara fillimit të praktikës profesionale.
- Angazhimin e Specialistëve më me përvojë të shoqërisë "Techno Plastic" Vlorë, të cilët zotërojnë të paktën titullin Master i Shkencave ose Ekuivalent i tij, në procesin mësimor në programet e studimit Bsc. Inxhinieri Mekanike, Navale, Elektrike, në funksion të nevojave të shprehura me shkrim nga Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare – Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore.
- Sigurimin e ambienteve të përshtatshme brenda territorit të ndërmarrjes për realizimin e seancave mësimore të praktikave profesionale.
- Realizimin e praktikave (mësimore dhe profesionale) të programeve të fushave të Inxhinierisë Mekanike, Navale dhe Elektrike të ofruara nga Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore, Departamenti Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare.

Neni 3 **Fusha e bashkëpunimit**

Pjesë e këtij bashkëpunimi do të jenë:

- Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore, Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë.
- Shoqëria “TechnoPlastic”, Vlorë.

Ky bashkëpunim përfshin realizimin e programeve mësimore në dy cikle studimi:

- Cikli i parë i studimeve të nivelit Bachelor.
- Cikli i dytë i studimeve të nivelit Master.

Palët nënshkruese do të bashkëpunojnë në këto fusha:

- Leksionet dhe seminarët në module mësimore të caktuara.
- Praktikat mësimore.
- Praktikat profesionale.
- Detyrat e kursit dhe Tema Diplomash.

Neni 4 **Detyrimet e palëve**

Secila palë e Marrëveshjes do të caktojë një person ndërlidhës për të koordinuar dhe zhvilluar realizimin e aktiviteteve ose të programeve specifike.

Personeli i Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore, studentët e programeve mësimore të Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore si dhe personeli i shoqërisë “TechnoPlastic”, Vlorë janë të detyruar të zbatojnë kushtet e kësaj Marrëveshjeje, për të cilat është rënë dakort nga titullarët/përfaqësuesit e të dy palëve.

Amendamente të mundshme ose shtesa të kësaj Marrëveshjeje do të formulohen dhe parashtrihen me shkrim dhe do të jenë pjesë e një aneksi të marrëveshjes.

Neni 5 **Respektimi i marrëveshjes**

Palët bien dakord që, nëse për arsye grevash, ose mosmarrëveshjesh të punës, çrregullimeve civile, motit të keq, fuqive Madhore ose shkaqeve të tjera të pashmangshme, shkaktuar përtej mundësisë që kanë ato për t'i kontrolluar, në mbështetje të këtij paragrafi, nëse institucionet nuk janë të afta të kryejnë detyrimet e tyre, kjo pamundësi e tyre nuk do të konsiderohet si prishje e Marrëveshjes.

Neni 6 **Përdorimi i të dhënave**

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë dhe Shoqëria “TechnoPlastic” Vlorë kanë detyrimin në mbrojtjen e të dhënave konform ligjit Nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave

personale”, i ndryshuar, si dhe ruajtjen dhe mospërdorimin e informacioneve e tjera të shkëmbyera prej tyre në lidhje me këtë Marrëveshje.

Neni 7

Afati i marrëveshjes

Kjo marrëveshje do të lidhet për një kohëzgjatje 5 (pesë) vjeçare nga data e nënshkrimit. Pas përfundimit të datës së përcaktuar në paragrafin e mësipërm, kjo marrëveshje mund të zgjatet bazuar në një marrëveshje të përbashkët me shkrim. Marrëveshja mund të zgjidhet nga secila Palë nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim Palës tjetër, të paktën 6 (gjashtë) muaj përpara.

Neni 8

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi do të zgjidhet përmes mirëkuptimit dhe negociatave mes Palëve.

Neni 9

Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj. Kjo marrëveshje është hartuar në (4) kopje origjinale në gjuhën Shqipe, nga një kopje do të depozitohen në Rektoratin e Universitetit Vlorë dhe Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore, 2 (dy) kopje do të depozitohet pranë TechnoPlastic Vlorë.

PËR

UNIVERSITETIN “ISMAIL QEMALI” VLORE

REKTORE

PROF. DR. AURELA SALIAJ



PËR

SHOQËRIA “TECHNOPLASTIC” VLORE

ADMINISTRATOR

Z.ALTIN DEMAJ

